



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. _____

Tiranë më: _____

Drejtuar: _____
NIPT: _____
Qyteti: _____
Bashkia: _____
Qarku: _____
Adresa: _____

I nderuar Tatimpagues!

Përmes kësaj letre, duam t'ju njoftojmë se aktiviteti që ju ushtroni është pjesë e listës së vendimit të qeverisë, dhe si i tillë nga 1 janari 2024 do të ttohëni me 15%.

Administrata Tatimore ju bën thirrje që të deklaroni saktë kodin tuaj ekonomik ose të ndryshoni kodin aktual nëse nuk përputhet me aktivitetin tuaj.

Korrigjimi i kodit ekonomik bëhet online nëpërmjet shërbimeve "Aplikim për ndryshim të personit fizik" ose "Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)".

Gjithashtu, ju inkurajojmë të pasqyroni saktë të dhënat në Deklaratën Vjetore të Tatimit mbi Fitimin apo Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, për vitin 2023, në lidhje me të dhënat e deklaruara për të ardhurat, shpenzimet dhe fitimin e tatuëshëm, pasi këto të dhëna do të jenë objekt i vlerësimit nga Administrata Tatimore për përlogaritjen e tatim fitimit paraprak gjatë vitit 2024.

Administrata Tatimore sqaron se gjatë vitit 2024 si viti i parë i zbatimit të ligjit të ri, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënies me tatimpaguesit, qasja e saj do të fokusohet drejt këshillimit me synim lehtësimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore nga ana e tyre.

Administrata Tatimore nuk ka asnjëherë për qëllim penalizimin e tatimpaguesve, aq më tepër kur kemi të bëjmë me një ligj totalisht të ri sa i përket tatimit mbi të ardhurat.

Duke shpresuar në kontributin tuaj si tatimpagues dhe qytetar,

Punë të mbarë!

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ceno Klosi



Adresa: Rr. Gjin Bue Shpata, Pranë Stadiumit Selman Stermasi

Tel: +355 42276800

Website: www.tatime.gov.al